



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 2... Prot.

Tiranë, më 03. 01.2017

LËNDA: PËR NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR

DREJTUAR: DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE

ZYRAVE ARSIMORE

Të nderuar drejtorë dhe përgjegjës të DAR/ZA-ve,

Bazuar në Urdhrin Nr. 01, datë 03.01.2017 të ministrit të Shëndetësisë "Për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së virusit të gripit", në mbështetje të neneve 25 dhe 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 38 të Urdhrit Nr. 43, datë 19.08.2013 "Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar", mësimi ndërpritet në të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, në datat 4, 5 dhe 6 janar 2017.

Ju faleminderit,

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

